

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Mirëbesimi / *eth-Thikah* / التَّكْوِينُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"فَإِذَا خِفتِ عَلَيْهِ فَأَلْقِيهِ فِي الْيَمِّ"

"Kur të kesh frikë për të, hidhe në lum."¹ (el-Kasas, 7)

Mirëbesimi ndaj Allahut është thelbi i *tewekkul* (mbështetjes te Ai), është zemra e *tefwid* (lënies së çështjes në dorë të Tij), dhe është bërthama e *teslim* (dorëzimit ndaj Tij).² Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është niveli i dëshpërimit, domethënë që robi të humbë shpresën se mund ta zmbarsë caktimin e Allahut, kështu që ai:

- Heq dorë nga përpjekja për hiset (e të tjerëve)³
- Heq dorë nga harbutëria e guximit prej mendjelehti⁴

¹ Mirëbesimi shembullor që bërë nga nëna e peygamberit Musa, kur ajo hodhi Musën (foshnje) në lum pasi pranoi shpallje nga Allahu për të vepruar kësisoj. Sigurisht, një veprim i këtillë s'do të ishte i pranueshëm pa një shpallje të qartë. Shpallja e qartë për ne është ajo që i Dërguari i Allahut ﷻ na e përcolli dhe ajo çfarë na mësojnë dijetarët eminentë të kohës sonë. Përtej kësaj është frymëzimi (*ilhaam*) dhe intuita (*dhewk*) të cilat plotësojnë, por assesi nuk zëvendësojnë shpalljen.

² Asnjë nga këto shkallë apo stacione nuk mund të merren me mend pa i zënë besë Allahut. Ky është shpirti i këtyre shkallëve dhe burimi nga i cili rrjedhin.

³ Tërë kjo artikullohet për bukuri në hadithin e peygamberit ﷺ, ku ai thotë: "Shpirti i shenjtë (Xhibrili) më frymëzoi se asnjë njeri s'do të vdesë pa përfunduar afatin e paracaktuar dhe pa harxhuar furnizimin e vet. Prandaj, kini frikë Allahun dhe kërkoni t'i realizoni hirshëm synimet që keni." (Shënuar nga Ebu Nu'ejm në *el-Hiljeh* nga Ebu Umameh). Hiri këtu nënkupton ruajtjen e mirësjelljes ndaj Allahut dhe ndaj krijesave të Tij.

⁴ Duke kërkuar prej Tij atë çfarë Ai nuk caktoi për ty. Megjithatë, ti duhet ta lutësh Atë për të gjitha nevojat që ke, por jo ta ngutësh Atë apo të dëshpërohesh, nëse ti nuk merr atë që kërkon.

Niveli i dytë është niveli i sigurisë, domethënë që të pushosh së pasuri frikë se do të humbësh atë që është caktuar ta kesh apo se do të ndryshojë ajo që është shkruar, duke arritur kështu:

- Ta fitosh kënaqësinë e rehatisë shpirtërore; nëse jo këtë,⁵
- Nivelin e bindjes së të parit;⁶ nëse jo këtë,
- Mirësinë e durimit

Niveli i tretë është të parët e përjetësisë së pafilluar (*ezelijeh*) të të Vërtetit, duke larguar kështu:

- Sprovat në shtegun e realizimit të qëllimeve⁷
- Shqetësimin e vetëmbrojtjes⁸
- Mbështetjen në mjetet apo mënyrat e ngritjes⁹

⁵ Ky është çmimi më i lartë, duke qenë se ti mund të jesh i bindur për fatin dhe pashmangshmërinë e tij dhe megjithëkëtë të mos jesh i kënaqur, pra ende të ndiesh bezdi në zemrën tënde për caktimet e Allahut; për të kaluarën, për të tashmen apo për dhe të ardhmen.

⁶ Të kesh besim të plotë, që është si besimi i një dëshmitari pamor që sheh atë çfarë sheh; po ashtu kjo nënkupton bindjen se Allahu të mjafton dhe, gjithçka që ndodh në jetën tënde, s'është gjë tjetër veçse materializimi i asaj çfarë është shkruar në Pllakën e Ruajtur.

⁷ Sprovat do të jenë më pak të dhembshme me mirëbesimin ndaj Allahut dhe pasjen e Tij si synim përfundimtar.

⁸ Shqetësimi që vjen nga nevoja për t'u vetëmbrojtur nga të gjitha dëmet.

⁹ Zbatimi i mjeteve të përshtatshme për arritjen e kënaqësisë së Tij dhe të mirëqenies sonë duke mos u mbështetur në ndikimin e natyrshëm të mjeteve në ngritjen tonë, por në dashmirësinë e Tij.